

Aneksi A**SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

Tabela .1

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Kamarier	Rep.Usht. 6630	Pogradec	3-mujore	po	-	11.12.19	25.12.19

Formulari nr. 1

1.Pozicioni i punës: Kamarier
2. Kodi i pozicionit: LF 2370
3. Reparti/Institucioni: Reparti Ushtarak nr. 6630
4. Vendi: (Shtëpia Pushimit Pogradec)
5. Paga: Vendim i KM nr 202, datë 15.03.2017 “Për pagat e punonjësve mbështetës”
6. Lloji i kontratës së punës: 3-mujore
7. Data e fillimit të aplikimit: 11.12.2019
8. Data e mbylljes së aplikimit: 25.12.2019
<p>9. Mënyra e aplikimit: Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes në adresën www.mod.gov.al .Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës, do t'i dërgohet Njësisë së Personelit të Strukturës që është e interesuar për rekrutimin, brenda afatit të caktuar, në zarf, dorazi ose në rrugë postare në adresën (adresa postare e repartit/strukturës përkatëse): Psh.</p> <p><i>Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Personelit Ministria e Mbrojtjes Rruga e Dibrës</i></p> <p><i>Tiranë</i></p>

10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së mesme/parauniversitare ose të lartë të noterizuar ose në origjinal;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV).
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike ëëë. mod.gov.al. (*linku: Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë të dënuar me burg me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a. Grada/Titulli:
- b. Arsimi :
- c. Kualifikimi:
- d. Trajnimi:
- e. Eksperienca në Punë:
- f. Gjuha e huaj:
- g. Kërkesa të tjera specifike:
- h. Niveli i certifikatës së sigurisë:

13. Përshkrimi i punës:

a. Detyrat kryesore:

Kryen servirjen e ushqimit, mëngjesit, drekës dhe darkës, në restorantin e shtëpisë pushimit/ rezidencës dhe të gjitha punët që kanë të bëjnë me shërbimin e kamerierit

Të vendosë tavolinat sipas skemës së shërbimit dhe të organizojë (dollarin e shërbimit) për shërbimin e drekës dhe darkës sipas rregullit etj

b. Përgjegjësitë:

Te prese dhe të përcjelle pushuesit, gjithashtu tu shërbejë atyre me cilësi dhe korrektësi

Të prezantojë dhe rekomandojë menynë pushuesit, gjithashtu të japë informacionin për përgatitjen e pjatave, përbërësit dhe mënyrën e gatimit